

20090901682

L I G J **PËR KONTROLLIN PUBLIK TË BRENDSHËM FINACIAR**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Lënda e rregullimit

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohet sistemi i kontrollit publik të brendshëm financiar i cili përfshin menaxhimin dhe kontrollin financiar, revizionin e brendshëm dhe harmonizimin e tyre, të vendosur në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontroll dhe revizion të brendshëm.

(2) Me këtë ligj rregullohet edhe organizimi, standardet, metodologjia, marrëdhëniet dhe përgjegjësitë, si dhe kompetencat e ministrit të Financave dhe të trupave konsultative për kontrollin publik të brendshëm financiar.

2. Koordinimi i sistemit për kontrollin publik të brendshëm financiar

Neni 2

(1) Ministri i Financave është kompetent për koordinimin e zhvillimit, vendosjes, zbatimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të kontrollit publik të brendshëm financiar, ndërsa në emër të tij Njësia qendrore për harmonizimin e sistemit të kontrollit publik të brendshëm financiar në Ministrinë e Financave (në tekstin e mëtejme: Njësia qendrore për harmonizim).

(2) Koordinimin nga paragrafi (1) i këtij neni ministri i Financave e kryen nëpërmjet:

- harmonizimit dhe mbikëqyrjes së udhëheqjes financiare dhe kontrollit;
- harmonizimit dhe mbikëqyrjes së revizionit të brendshëm; dhe
- përgatitjes dhe miratimit të akteve nënligjore, doracakëve dhe orientimeve.

3. Definicione

Neni 3

Nocione të veçanta të përdorura në këtë ligj kanë këtë domethënie:

1. Mjete publike janë të gjitha mjetet e paguara, të pranuar, të fituara, të ndara dhe të shpenzuara nga subjektet e sektorit publik, duke përfshirë edhe të hyrat buxhetore, kërkesat, shpenzimet dhe subvencionet.

2. Subjekte të sektorit publik janë shfrytëzuesit e mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, fondet, komunat dhe Qyteti i Shkupit, agjencitë dhe institucionet tjera të themeluara me ligj, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe personat tjerë juridikë të cilët janë në pronësi të shtetit ose në të cilat aksionar është shteti.

3. Menaxhim dhe kontroll financiar është sistemi i politikave, procedurave dhe i aktiviteteve të vendosura nga udhëheqësi i subjektit, me qëllim që të sigurohet bindje e arsyeshme se qëllimet e subjektit janë realizuar.

4. Bindje e arsyeshme është niveli i kënaqshëm i besimit për çështje të caktuar duke marrë parasysh harxhimet, përfitimet dhe rreziqet.

5. Persona përgjegjës për menaxhim financiar dhe kontroll janë udhëheqësi i subjektit dhe udhëheqësit e njësive organizative të nënrenditura në subjekt..

6. Kontrollor financiar është personi i autorizuar në subjekt për kontrollin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së vendimeve të propozuara financiare, si dhe lejimin ose kontestimin e tyre, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit.

7. Kontroll financiar Ex-ante është procedura me të cilën sigurohet që obligimi financiar të mos ndërmerret dhe të dalat të mos paguhen pa lejen paraprake të personit zyrtar me hierarki pavarësisht nga personi i autorizuar për ndërmarrjen e obligimeve financiare dhe personi i autorizuar për pagesë.

8. Person i autorizuar për ndërmarrjen e obligimeve financiare është personi i autorizuar zyrtar i cili mund të ndërmarrë obligime financiare.

9. Person i autorizuar për pagesë është personi i autorizua zyrtar i cili mund të japë urdhërpagesë.

10. Ex-post kontroll financiar është procedura e cila zbatohet te subjekti me të cilin sigurohet që transaksionet financiare në formë të obligimeve, të dalave dhe të hyrave të jenë të kontrolluara, pasi transaksioni të përfundojë tërësisht.

11. Menaxhim financiar i qëndrueshëm dhe kontroll është shfrytëzimi transparenti, i rregullt, ekonomik, efikas dhe efektiv i mjeteve në dispozicion.

12. Ekonomizim është minimizimi i resurseve të përdorura për arritjen e qëllimeve ose rezultateve të planifikuara të aktivitetit të caktuar, duke marrë parasysh kualitetin e caktuar të këtyre efekteve dhe rezultateve.

13. Efektivitet është shkalla deri në të cilën janë arritur qëllimet e aktivitetit të caktuar ose raporti ndërmjet efektit të planifikuar dhe efektit real të aktivitetit të caktuar.

14. Efikasitet është zmadhimi i efekteve ose rezultateve nga aktiviteti i caktuar në mënyrë adekuate me mjetet e investuara.

15. Gjurmë revizore është rrjedhë e dokumentuar e transaksioneve financiare dhe të tjera nga fillimi i tyre deri në fund, me qëllim të mundësimit të rikonstruktimit të të gjitha aktiviteteve të caktuara dhe lejimi i tyre dhe i përfshin sistemet e dokumentimit, njoftimin, kontabilitetin dhe arkivimin.

16. Arkëtar është personi i autorizuar zyrtar i angazhuar për pagesën dhe marrjen e parave në dorë;

17. Autorizim është e drejta e marrjes së vendimeve në emër të dhënësit të autorizimit dhe mund të jetë i përgjithshëm dhe i veçantë.

18. Autorizim i përgjithshëm është dhënia e autorizimit për zbatimin e kompetencës së plotë për të cilën është përgjegjës dhënësi i autorizimit.

19. Autorizim i veçantë është autorizimi i cili jepet për rast të caktuar.

20. Nënautorizim është leja që pranuesi i autorizimit t'ia bartë plotësisht ose pjesërisht autorizimin e pranuar udhëheqësit të njërive organizative themelore të cilat janë nën përgjegjësinë e tij të drejtpërdrejtë.

21. Dhënës i autorizimit është udhëheqësi i subjektit, i cili jep autorizim.

22. Pranues i autorizimit është personi i cili ka pranuar autorizim nga dhënësi i autorizimit për shkak të vendosjes dhe ndërmarrjes së veprimeve në emër të tij.

23. Detyrim financiar është detyrimi për pagesë i shprehur në para, mjete materiale, pronë ose të drejta.

24. Rrezik është mundësia e ndodhjes së ngjarjes me ndikim negativ në realizimin e qëllimeve të subjektit.

25. Menaxhim me rrezikun është procesi i verifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të brendshme dhe të jashtme të cilat mund të ndikojnë negativisht në përmbushjen e qëllimeve të subjektit dhe zbatimin e kontroleve të nevojshme me qëllim që ekspozimi në rrezik të jetë në nivel të kapshëm ose të zvogëlohen pasojat nga rreziku i mundshëm në nivel të kapshëm.

26. Kontroll janë të gjithë aktivitetet e ndërmarra me qëllim që t'u iket ose të zvogëlohen rreziqet.

27. Mision është shkaku kryesor për ekzistimin dhe punën e subjektit, ndërsa përbëhet nga sfera e punës, vlerat dhe qëllimet të cilat dëshirohet të realizohen.

28. Mbikëqyrje (supervizion) është përgjegjësi menaxhimi e cila u ndihmon subjekteve në realizimin e qëllimeve, përpunimin, shqyrtimin dhe lejimin e punëve, ndarjen e qartë të detyrave dhe përgjegjësi të dhëna çdo të punësuar, kontrollimin sistematik të kryerjes së punëve të çdo të punësuar deri në nivelin e nevojshëm dhe lejimin e kryerjes së punëve në pjesët e rëndësishme me çka sigurohet kryerja e punëve të planifikuara.

29. Raporte financiare themelore janë bilanci i gjendjes, bilanci i të hyrave dhe të dalave, bilanci i konsoliduar i pronës kapitale (regjistrimi i pronës kapitale), bilanci për hyrjen në borxh dhe shënimet/arsyetimi ndaj raporteve financiare.

30. Revizioni i brendshëm është aktivitet i pavarur i dhënies së bindjes dhe këshillës objektive, i vendosur më qëllim që të kontribuojë në rritjen e vlerës dhe përmirësimin e punës së subjektit. Ai ndihmon që subjekti t'i plotësojë qëllimet e tij, duke zbatuar qasje sistematike dhe disiplinore për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit në proceset e menaxhimit me rrezikun, kontrollin dhe menaxhimin.

31. Revizion i sistemeve për kontroll të brendshëm është vlerësimi rrënjësor i funksionimit të sistemeve për kontroll të brendshëm.

32. Revizion i suksesit të punës (kryerja) është vlerësimi i ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit të punës dhe shfrytëzimit të mjeteve në sferë të definuar të aktiviteteve ose programeve;

33. Revizion financiar është kontrolli i saktësisë, tërësisë dhe ligjshmërisë së evidencës së kontabilitetit dhe raporteve financiare.

34. Revizion i harmonizimit (rregullsia) është vlerësimi se a është puna në pajtim me ligjet, aktet nënligjore dhe interne të cilat janë në fuqi.

35. IT revizion është vlerësimi rrënjësor i punës së sistemeve teknologjike informative.

36. Pavarësi e revizionit të brendshëm është mosekzistimi i kushteve të cilat e rrezikojnë objektivitetin.

37. Objektivitet në revizionin e brendshëm është sjellja pa paragjykime, e cila nuk bazohet në gjykimin e të tjerëve;

38. Kompetencë e revizionit të brendshëm është posedimi i njohurive dhe shkathtësive relevante;

39. Profesionalizëm në revizionin e brendshëm është zbatimi i sjelljes me brengosje dhe shkathtësi të personit zyrtar të kujdesshëm dhe kompetent;

40. Integritet në revizionin e brendshëm është mospjesëmarrja me vetëdije në aktivitet jolegal ose mosndërmarrja e aktiviteteve të cilat e diskreditojnë profesionin revizor i brendshëm ose subjektin;

41. Besueshmëri në brendësinë e revizionit është respektimi i vlerës dhe pronësisë së informatës e cila nuk duhet të zbulohet pa autorizim, përveç në rastet e obligimit ligjor ose profesional;

42. Dyshim për mashtrim është veprimi i ndërmarrë ose i pa ndërmarrë nga i cili me arsye mund të miratohet konkluzion për prezantim të qëllimshëm ose të gabueshëm të fakteve materialeve ose financiare.

43. Kodeksi etik i revizorëve të brendshëm është Kodeksi etik i Institutit për Revizorë të Brendshëm.

44. Kartë për revizion të brendshëm është akti intern i nënshkruar nga udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm dhe udhëheqësi i subjektit me të cilën vendosen qëllimet, autorizimet dhe përgjegjësitë e revizionit të brendshëm.

45. Standarde ndërkombëtare për revizion të brendshëm janë Standardet ndërkombëtare për kryerjen profesionale të revizionit të brendshëm (International Standards for the Professional Practice of Internal Audit) të Institutit për Revizor të Brendshëm (The Institute of Internal Auditors, USA/IA, Inc).

46. Standarde ndërkombëtare për revizion janë standardet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (International Federation of Accountants/IFAC/);

II. MENAXHIMI DHE KONTROLLI FINANCIAR

1. Përfshirja e menaxhimit dhe kontrollit financiar

Neni 4

Menaxhimi dhe kontrolli financiar në pajtim me këtë ligj vendoset te shfrytëzuesit e buxhetit nga sfera pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (pushteti qendror), fondet, komunat dhe Qyteti i Shkupit (në tekstin e mëtejme: subjekte).

Neni 5

(1) Menaxhimi dhe kontrolli financiar i subjektit i përfshin proceset financiare të planifikimit, përbarimit, monitorim dhe njoftimit për:

- grumbullimin e të hyrave të verifikuara në Buxhet,
- menaxhimin dhe kontrollin për përbarimin e shpenzimeve të miratuara me buxhetin, dhe
- mbrojtjen e mjeteve dhe obligimeve vlera e të cilave është evidentuar në bilancin e gjendjes.

(2) Menaxhimi dhe kontrolli financiar duhet të zbatohet në të gjitha njësitë organizative dhe në të gjitha nivelet e subjektit dhe i përfshin të gjitha mjetet e subjektit, duke përfshirë mjetet e Unionit Evropian dhe nga burimet tjera.

(3) Sistemi për udhëheqje dhe kontroll financiar duhet të vlerësohet dhe zhvillohet vazhdimisht për shkak të realizimit efikas të misionit dhe qëllimeve të subjektit.

2. Qëllimi i menaxhimit dhe kontrollit financiar

Neni 6

Qëllimi i menaxhimit dhe kontrollit financiar është përmirësimi i menaxhimit financiar për shkak të arritjes së këtyre qëllimeve të përgjithshme:

- kryerjes së punëve në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efektive dhe efikase;
- harmonizimit të punës me ligjet, dispozitat e tjera, politikat e verifikuara, planet dhe procedurat;
- mbrojtjes së pronës dhe resurseve tjera të humbjeve të shkaktuara nga udhëheqja e keqe, harxhimi dhe shfrytëzimi i paarsyeshëm, si dhe prej parregullsive dhe keqpërdorimit;
- forcimit të përgjithësisë për realizimin e suksesshëm të detyrave;
- evidentimit të drejtë të transaksioneve financiar, dhe
- njoftimit financiar në kohë dhe përcjelljes së rezultateve nga puna.

3. Përgjegjësia dhe raporti i punës së udhëheqësit të subjektit

Neni 7

(1) Udhëheqësi i subjektit është përgjegjës për:

- përgatitjen e buxhetit, përbarimin e buxhetit dhe njoftimin për buxhetin e subjektit me cilin menaxhon;
- menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe revizionin e brendshëm në gjithë strukturat organizative, programet, operacionet dhe proceset, të udhëhequra nga ai;
- kontrollin e udhëheqjes së kontabilitetit, marrjen e detyrimeve financiare dhe kryerjen e pagesave, grumbullimin e të hyrave dhe mbrojtjen e mjeteve dhe detyrimeve;
- vlerësimin e vazhdueshëm të sistemit për menaxhim dhe kontroll financiar;
- përcaktimin dhe realizimin e qëllimeve të subjektit dhe përgatitjen e realizimin e planeve strategjike dhe planeve tjera, si dhe të programeve për realizimin e të përgjithshme dhe të veçanta të subjektit;
- vendosjen e strukturës organizative dhe procedurat për punën me të cilat do të sigurohet funksionimi, përcjellja dhe zhvillimi udhëheqjes dhe kontrollit të qëndrueshëm financiar;

- vendosjen e linjës së njoftimit në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë e transmetuara;
- kompetencën e të gjithë të punësuarve për kryerjen e detyrave në pajtim me udhëheqjen dhe kontrollin financiar, dhe

- menaxhimin me rreziqet dhe vendosjen e kontrolleve të brendshme efikase dhe përkatëse.

(2) Udhëheqësi i subjektit ka dhënë raport për arritjen e qëllimeve të subjektit nga sektori publik nëpërmjet udhëheqjes me mjetet publike në mënyrë ligjore, ekonomike, efektive dhe efikase.

4. Përgjegjësia dhe dhënia e autorizimit

Neni 8

(1) Udhëheqësi i subjektit me akt mund t'u japë autorizim (në mënyrë të përgjithshme ose të veçantë) njërit ose më shumë personave udhëheqës të cilët i janë vartës të drejtpërdrejtë sipas hierarkisë.

(2) Me aktin për autorizim mund të jepet nënautorizim.

(3) Akti për autorizim ose nënautorizim mund të përmbajë kushte për shfrytëzimin e autorizimit.

(4) Në bazë të autorizimit dhe nënautorizimit nuk mund të merren vendime me ndikim të rëndësishëm politik ose financiar pa lejen paraprake nga udhëheqësi i subjektit.

(5) Udhëheqësi i njësisë organizative në subjekt të cilët kanë marrë autorizim nëpërmjet delegimit ose nën-delegimit mund të veprojnë vetëm në suaza të përkufizimeve të verifikuara me aktin për delegim ose nën-delegim dhe i përgjegjen dhënësit të autorizimit për shfrytëzimin e autorizimit.

(6) Vendimet nga autorizimi përgatiten dhe nënshkruhen në emër të udhëheqësit të subjektit. Udhëheqësi i subjektit për autorizimet e dhëna vazhdon të jenë përgjegjës për gjithë vendimet e miratuara, duke përfshirë dhe vendimet që i përkasin udhëheqjes dhe kontrollit financiar.

(7) Ministri i Financave së afërmi e përcakton mënyrën për dhënien e autorizimeve.

5. Njësia për çështje financiare

Neni 9

(1) Udhëheqësi i subjektit themelon njësi të veçantë organizative për çështje financiare (në tekstin e më tejme: njësi për çështje financiare) si sektor ose seksion, udhëheqësi i së cilës i përgjigjet drejtpërdrejt udhëheqësit të subjektit dhe nëpunësit më të lartë shtetëror.

(2) Njësia për çështje financiare është kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e udhëheqjes dhe kontrollit financiar.

(3) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e kryerjes së punëve nga kompetenca e njësisë për çështje financiare.

6. Kushtet që duhet t'i plotësojë udhëheqësi i njësisë për çështje financiare

Neni 10

Udhëheqës i njësisë për çështje financiare te subjekti mund të emërohet personi i cili përveç kushteve të përgjithshëm për punësim të verifikuara me ligj, duhet t'i plotësojë edhe kushtet në vijim:

- të ketë arsim të lartë nga sfera e ekonomisë,

- të ketë përvojë pune së paku tri vjet në sferën e financave, dhe

- me vendim të gjykatës të mos i është shqiptuar masa ndalesë për kryerjen e veprimtarisë ose të profesionit derisa zgjat ndalesa.

7. Kompetencat e udhëheqësit të njësisë për çështje financiare

Neni 11

(1) Udhëheqësi i njësisë për çështjet financiare bën mbikëqyrje dhe e këshillon udhëheqjen e subjektit, veçanërisht për:

- kontrollin e buxhetit (kontrollin e përgatitjes dhe përmbarimit të buxhetit),
- kontrollin financiar ex ante,
- kontrollin e zbatimit të politikës së verifikuar dhe udhëheqjes operative (mbikëqyrjen mbi procesin e përgjithshëm të udhëheqjes dhe kontrollit të brendshëm),
- kontabilitetin, dhe
- informimin financiar dhe buxhetor.

(2) Udhëheqësi i njësisë për çështje financiare:

- e koordinon procesin për përgatitjen dhe ndryshimin e plotësimin e buxhetit dhe planit strategjik të subjektit,
- e koordinon procesin e zhvillimit, vendosjes, zbatimit dhe të mbajtjes së udhëheqjes dhe kontrollit financiar,
- e koordinon procesin e evidentimit të kontabilitetit për përmbarimin e buxhetit dhe përgatitjes së llogarisë vjetore dhe Raportit financiar vjetor nga neni (47) i këtij ligji,
- detyrimisht jep mendim për aktet e propozuara që i përgatisin njësitë tjera organizative në subjektin dhe propozim-aktet e subjekteve tjera që kanë ose mund të kenë implikime financiare për subjektin buxhetor,
- zbaton ex ante dhe ex post kontroll financiar, dhe
- zbaton mbrojtjen e mjeteve dhe detyrimeve vlera e të cilave është evidentuar në gjendjen e bilancit.

Neni 12

(1) Udhëheqësi i njësisë për çështje financiare përgatit plan për vendosjen e udhëheqjes dhe kontrollit financiar, si dhe metodologjinë për zbatimin e planit që i lejon udhëheqësi i subjektit.

(2) Udhëheqësi i njësisë për çështje financiare, në mënyrë përkatëse me nevojat dhe specifikën në punën e subjektit, mund të emërojë koordinator për udhëheqje dhe kontroll financiar që në mënyrë operative e zbaton dhe koordinon vendosjen dhe zhvillimin e udhëheqjes dhe kontrollit financiar të subjekti. Koordinatori për udhëheqje dhe kontroll financiar nuk guxon të zbatojë ex ante dhe ex post aktivitete kontrolluese.

(3) Personat e obliguar për vendosjen dhe zhvillimin administrimit udhëheqjes dhe kontrollit financiar nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni dhe personat e obliguar për zbatimin e llojeve të kontrollit së veçantë nga neni 21 paragrafi (1) të këtij ligji, janë të detyruar të kalojnë trajnim në pajtim me Programin për trajnim për vendosjen dhe zhvillimin administrimit udhëheqjes dhe kontrollit financiar që e miraton ministri i Financave, si dhe të bashkëpunojnë me Njësinë qendrore për harmonizim në Ministrinë e Financave në lidhje me vendosjen dhe zhvillimin e udhëheqjes dhe kontrollit financiar.

(4) Njësia qendrore për harmonizimin përgatit dhe azhurnon Doracak për udhëheqje dhe kontroll financiar që e lejon ministri i Financave. Doracaku për udhëheqje dhe kontroll financiar përmban orientime për mënyrën e vendosjes dhe të zbatimit të udhëheqjes dhe kontrollit financiar.

8. Komponentët e menaxhimit dhe kontrollit financiar

Neni 13

(1) Menaxhimi dhe kontrolli financiar zbatohet në bazë të standardeve të pranuar ndërkombëtare për kontroll të brendshëm, nëpërmjet zbatimit të komponentëve vijues të ndërlidhura në mënyrë të ndërsjellë:

- mjedisit kontrollues,

- menaxhimit me rreziqet,
- kontrolleve,
- informacioneve dhe komunikimeve, dhe
- monitorimit.

(2) Ministri i Financave i shpall në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” standardet e pranuar ndërkombëtarisht për kontroll të brendshëm.

9. Mjedisi kontrollues

Neni 14

Mjedisi kontrollues përfshin:

- integritetin profesional dhe personal të udhëheqësve dhe të të punësuarve në subjekt,
- mënyrën e mendimit dhe stilit të punës së udhëheqësit,
- strukturë organizative që siguron ndarjen e përgjegjësive, hierarkisë dhe rregullave të qarta, të drejtave, obligimeve dhe nivelit të informimit,
- politikat dhe praktikat e udhëheqjes me resurset njerëzore, dhe
- kompetencën e të punësuarve.

10. Menaxhimi me rrezikun

Neni 15

(1) Menaxhimi me rrezikun përfshin verifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e ndodhive të mundshme ose të rrethanave që mund të kenë ndikim negativ mbi arritjen e qëllimeve të subjektit për shkak të sigurimit të bindjes së arsyeshme se qëllimet do të realizohen.

(2) Për zbatimin e aktiviteteve nga paragrafi (1) të këtij neni, udhëheqësi i subjektit miraton strategji për menaxhim me rrezikun, e cila azhurnohet në çdo tri vjet edhe në rastet kur rreziku ndryshon dukshëm. Kontrollat që kanë të bëjë me minimizimin e rrezikut duhen të analizohen dhe azhurnohen së paku një herë në vit.

11. Kontrollat

Neni 16

Kontrollet përfshijnë:

- procedurat për autorizim dhe lejim,
- ndarjen e detyrave në mënyrë me të cilën nuk do të lejohet që një person zyrtar në të njëjtin kohë të jetë përgjegjës për lejimin, përmbarimin, kontabilitetin dhe kontrollin,
- sistemin e nënshkrimit të dyfishtë,
- rregullat për qasje deri te mjetet dhe informatat,
- ex-ante dhe ex post kontrollin financiar,
- procedurat për kontabilitet të plotë, të saktë, preciz dhe të azhurnuar të të gjitha transaksioneve,
- njoftimin dhe kontrollin e aktiviteteve-vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të transaksioneve,
- procedurat për monitorim,
- procedurat për menaxhim me resurset njerëzore, dhe
- rregullat për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe aktiviteteve lidhur me aktivitetet e subjektit.

12. Informacione dhe komunikime

Neni 17

Informacionet dhe komunikimet përfshijnë:

- verifikimin, grumbullimin dhe sistemimin, në formë adekuate dhe kornizë kohore, informacione të besueshme dhe të sigurta me të cilat mundësohet që çdo person përgjegjës të ndërmarrë përgjegjësi adekuate,

- komunikimin efektiv horizontal dhe vertikal në të gjitha nivelet e hierarkisë në subjektin,
- ndërtimin e sistemit informativ adekuat për udhëheqje me subjektin në kuptimin që të punësuarit t'i dinë rregullat e qarta dhe precize dhe instruksionet për rolin e tyre si dhe përgjegjësitë lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin,
- dokumentimin dhe pasqyrën grafike të sistemit i cili përmban rregulla për përgatitjen, realizimin, bartjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve,
- dokumentimin e të gjitha proceseve dhe transaksioneve operative me qëllim që të sigurohet gjurma revizore adekuate për ndjekje dhe monitorim, dhe
- zhvillimin e sistemit efektiv, me kohë dhe të besueshëm për njoftim i cili përfshin: nivele dhe afate përfundimtare për njoftim; raporte që u prezantohen udhëheqësve; forma të njoftimit pas zbulimit të gabimeve, parregullsi, keqpërdorime, mashtrim ose përdorim jo të qëllimshëm të mjeteve.

13. Monitorimi

Neni 18

(1) Me monitorimin kontrollohet funksionimi adekuat i sistemit për menaxhim financiar dhe kontroll.

(2) Monitorimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit veçanërisht duhet të zhvillohet përmes ndjekjes së përhershme, vetëvlerësimeve dhe revizioneve të brendshme.

(3) Udhëheqësi i subjektit përmes njësisë për çështje financiare gjatë vitit kryen vetëvlerësimin e proceseve të ndara të sistemit për administrim financiar dhe kontroll në subjektin me të cilin udhëheq, ndërsa një herë në 5 vjet zbaton vetëvlerësimin e strukturës dhe funksionimin e tërë sistemit për administrim financiar dhe kontroll.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, vetëvlerësimi mund të mos zbatohet në pjesën e ndarë organizative të subjekti ose për proces specifik financiar nëse rezultati nga menaxhimi me rrezikun jep argumente të mira për moszbatimin e vetëvlerësimit.

(5) Udhëheqësi i njësisë për çështje financiare e informon udhëheqësin e njësisë për revizion të brendshëm për rezultatet nga vetëvlerësimet e kryera.

(6) Udhëheqësi i subjektit në Raportin financiar vjetor nga neni 47 të këtij ligji, paraqet raportin për vetë-vlerësimet nga paragrafi (3) i këtij neni të cilat janë kryer në vitin përkatës dhe për rezultatet nga vetë-vlerësimet të cilat nuk janë plotësisht pozitive.

(7) Raporti nga paragrafi (6) i këtij neni, i përfshin komentet e udhëheqësit të subjektit që kanë të bëjnë me rekomandimet nga vetëvlerësimet.

(8) Udhëheqësi i subjektit në Raportin financiar vjetor nga neni 47 të këtij ligji jep mendim për administrimin financiar dhe kontrollin.

14. Principet e kontabilitetit dhe njoftimit financiar

Neni 19

(1) Udhëheqësi i subjektit vendos kontabilitet dhe njoftim financiar që i siguron informacione adekuate që të mund ta mbikëqyrë dhe të jetë përgjegjës për funksionimin e administrimit financiar dhe kontrollit në kuadër të subjektit.

(2) Kontabiliteti vendoset dhe funksionon në pajtim me principet e rregullshmërisë, efikasitetit, ekonomizimit, kontrollit dhe rregullimit.

(3) Udhëheqësi i subjektit është përgjegjës për verifikimin e harmonizimit të të dhënave të marra nga persona të tretë me principet nga paragrafi (2) të këtij neni, nëse të hyrat ose të dalat varen nga ato të dhëna.

15. Personi i autorizuar për ndërmarrjen e obligimeve financiare, personi i autorizuar për pagesën dhe arkëtari

Neni 20

(1) Udhëheqësi i subjektit mund të emërojë persona të autorizuar për ndërmarrjen e obligimeve financiare, persona të autorizuar për pagesë dhe arkëtarë.

(2) Një person mund të kryejë vetëm një nga punët nga paragrafi (1) të këtij neni dhe duhet të jetë në mënyrë hierarkike i pavarur nga personat tjerë nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e zbatimit të proceseve financiare të përgjithshme.

16. Ex-ante dhe ex-post kontrolli financiar

Neni 21

(1) Udhëheqësi i subjektit është përgjegjës për ex-ante dhe ex-post kontrollin financiar.

(2) Për mënyrën e zbatimit të ex-ante dhe ex-post kontrolleve vendos udhëheqësi i subjektit, duke pasur parasysh nevojën dhe specifikat e punës gjatë analizave të zbatuara në rrezik.

(3) Ex-post kontrolli financiar i siguron instrumentet për mënjanimin e parregullsive të zbuluara të kontrolleve të brendshme dhe nuk duhet të zbatohet nga personat të cilët janë përgjegjës për ex-ante kontrollin financiar.

(4) Ex-post kontrolli përfshin edhe kontrollin detektiv që kryhet me zbatimin e plotë të vendimeve dhe transaksioneve financiare të miratuara me qëllim të zvogëlimit të rrezikut nga pasojat e padëshiruara dhe përmirësimin e procedurave ose të ex-ante kontrolleve.

17. Detyrime të veçanta financiare

Neni 22

(1) Udhëheqësi i subjektit mund të ndërmarrë detyrime financiare me para, mjete materiale, pronë ose të drejta në emër të Republikës së Maqedonisë për ndarje të subvencioneve, dotacioneve, ndihmës në para, huave ose garanci të palës së tretë dhe pjesëmarrje në kapitalin aksionar vetëm nëse ajo është përcaktuar me ligj.

(2) Kur propozohet miratimi i ligjit për ndërmarrjen e detyrimeve financiare nga paragrafi (1) të këtij neni nevojitet pëlqimi paraprak me shkrim nga ministri i Financave.

III. REVIZIONI I BRENDSHËM

1. Qëllimi, roli dhe principet e revizionit të brendshëm

Neni 23

Qëllimi i revizionit të brendshëm është që udhëheqësit të subjektit nga sektori publik t'i sigurojë bindje dhe këshillë të arsyeshme objektive të pavarur me qëllim të përmirësimit të punës së subjektit dhe rritjes së efektivitetit të sistemeve për kontroll të brendshëm.

Neni 24

Roli i revizionit të brendshëm është që t'u japë përkrahje udhëheqësve në subjektin nga sektori publik për realizimin e qëllimeve të subjektit përmes:

a) përpunimit të planeve strategjike dhe vjetore për revizion të brendshëm në bazë të vlerësimit objektiv të rrezikut, si dhe kryerjes së revizioneve të brendshme të veçanta në pajtim me planet e miratuara të revizionit;

b) vlerësimit të mënyrës përkatëse, ekonomizimit, efektivitetit dhe efikasitetit të sistemit për menaxhim financiar dhe kontroll për verifikim, vlerësim dhe menaxhim me rreziqet nga udhëheqësi e subjektit në lidhje me:

- harmonizimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve interne dhe marrëveshjeve,
- besueshmërinë dhe tërësinë e informacioneve financiare dhe operative,
- sigurinë e pronës dhe informacionet, dhe
- kryerjen e detyrave dhe realizimin e qëllimeve.

v) dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e punës dhe procedurave të punës, dhe

g) monitorimit të zbatimit të masave të ndërmarra nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik në bazë të revizioneve të kryera.

Neni 25

Revizioni i brendshëm zbatohet në pajtim me principet e ligjshmërisë, pavarësisë, objektivitetit, kompetencës, profesionalizmit, integritetit dhe besueshmërisë.

2. Standardet dhe metodologjia për kryerjen e revizionit të brendshëm

Neni 26

(1) Revizioni i brendshëm kryhet në pajtim me standardet e pranuar për kryerjen profesionale të revizionit të brendshëm, këtë ligj, aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, kartës për revizion të brendshëm dhe aktet interne të subjektit nga sektori publik të harmonizuara me këtë ligj.

(2) Revizorët e brendshëm, përveç akteve nga paragrafi (1) të këtij neni, në punën e tyre kanë për obligim që të zbatojnë edhe Kodeksin etik të revizorëve të brendshëm dhe orientimet dhe Doracakun për revizion të brendshëm nga neni 27 të këtij ligji.

(3) Standarde për kryerjen profesionale të revizionit të brendshëm janë standardet ndërkombëtare për revizion të brendshëm të cilat shpallen në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nga ana e ministrit të Financave.

(4) Ministri i Financave e përcakton kartën për revizion të brendshëm dhe Kodeksin etik të revizorëve të brendshëm.

Neni 27

Njësia qendrore për harmonizim përgatit dhe azhurnon Doracak për revizion të brendshëm të cilin e miraton ministri i Financave. Me Doracakun për revizion të brendshëm verifikohet metodologjia e punës dhe zbatimi i revizionit të brendshëm.

3. Llojet e revizionit të brendshëm

Neni 28

Revizioni i brendshëm përfshin:

- a) revizionin financiar,
- b) revizionin e harmonizimit (rregullimit),
- v) revizionin e sistemeve për kontroll të brendshëm,
- g) revizionin për sukses në punë (kryerje), dhe
- d) IT revizionin.

4. Përfshirja dhe organizimi i revizionit të brendshëm

Neni 29

(1) Revizioni i brendshëm zbatohet me të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset organizative të subjektet nga sektori publik.

(2) Njësia për revizion të brendshëm themelohet si seksion me së paku me dy revizorë të brendshëm, duke përfshirë edhe udhëheqësin e seksionit për revizion të brendshëm, përkatësisht si sektor me së paku me pesë revizorë të brendshëm, duke përfshirë edhe udhëheqësin e sektorit për revizion të brendshëm.

Neni 30

(1) Njësia për revizion të brendshëm, detyrimisht themelohet në:

- Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, ministritë, Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, Fondin për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë, Agjencinë për Rrugët Shtetërore të Republikës së Maqedonisë, Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë dhe Agjencinë për Nëpunës Shtetërorë.

(2) Njësi për revizion të brendshëm detyrimisht themelohet edhe në të gjitha subjektet e sektorit publik, buxheti mesatar vjetor/plani financiar i të cilit në tre vitet e fundit e tejkalon shumën prej 50 milionë denarësh.

(3) Subjekti i sektorit publik, buxheti mesatar vjetor/plani financiar i të cilit në tre vitet e fundit nuk e tejkalon shumën prej 50 milionë denarësh, revizionin e brendshëm e organizon me angazhimin e:

- revizorit/ve të brendshëm nga njësia për revizion të brendshëm të subjektit tjetër nga sektori publik, në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet udhëheqësve të të dy subjekteve nga sektori publik, ose

- revizorit/ve të përmendur në regjistrin e revizorëve të brendshëm nga neni 48 alineja 7 të këtij ligji.

(4) Me përjashtim të paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit të Financave në bazë të vlerësimit të bërë të rrezikut mund të verifikojë detyrim për themelimin e njësisë për revizion të brendshëm edhe te subjektet tjera nga sektori publik.

Neni 31

(1) Udhëheqësi i subjektit nga sektori publik themelon njësi për revizion të brendshëm në pajtim me kriteret si vijojnë:

- së paku me një revizor të brendshëm dhe udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, nëse buxheti mesatar/plani financiar i subjektit nga sektori publik në tre vitet e fundit ka arritur shumën prej së paku 50 milionë denarësh, përfshirë edhe fondet dhe programet e financuara nga UE,

- së paku me tre revizorë të brendshëm dhe udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, nëse buxheti mesatar/plani financiar i subjektit nga sektori publik në tre vitet e fundit ka arritur shumën prej së paku 500 milionë denarësh, përfshirë edhe fondet dhe programet e financuara nga UE,

- së paku me katër revizorë të brendshëm dhe udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, nëse buxheti mesatar/plani financiar i subjektit nga sektori publik në tre vitet e fundit ka arritur shumën prej së paku 2 miliardë denarësh, përfshirë fondet dhe programet e financuara nga UE, dhe

- së paku me një revizor të brendshëm në çdo pesë njësi shfrytëzuese të buxhetit.

(2) Numri minimal i të punësuarve në njësinë për revizion të brendshëm nga paragrafi (1) të këtij neni nuk i përfshin revizorët në stërvitje nga neni 36, paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 32

(1) Njësia për revizion të brendshëm zbaton revizion të brendshëm në subjektin nga sektori publik, shfrytëzuesit e njësive, të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset, përfshirë edhe ato të shfrytëzuesve të mjeteve nga fondet e UE, si dhe te personat juridikë dhe fizikë me të cilët subjekti te i cili bëhet revizioni i brendshëm ka marrëdhënie afariste dhe të cilët shfrytëzojnë mjete publike.

(2) Njësia për revizion të brendshëm, në subjektin që është përgjegjës për administrimin me programe/projekte ndërresor, e koordinon punën e njësive për revizion të brendshëm të subjekteve nga sektori publik të cilët marrin pjesë në zbatimin e programeve/projekteve.

5. Pavarësia organizative, profesionale dhe funksionale e njësisë për revizion të brendshëm

Neni 33

(1) Njësia për revizion të brendshëm në mënyrë organizative dhe funksionale e pavarur dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vetme i përgjigjet udhëheqësit të subjektit nga sektori publik.

(2) Pavarësia funksionale e njësisë për revizion të brendshëm sigurohet përmes pavarësisë së saj nga pjesët tjera organizative të subjektit në planifikimin e punës, kryerjen e revizionit të brendshëm dhe lajmërimin.

(3) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm dhe revizorët e brendshëm janë të pavarur gjatë kryerjes së revizionit të brendshëm, që e kryejnë në mënyrë profesionale duke aplikuar metodologjinë e bazuar në standardet ndërkombëtare për revizion të brendshëm, principet dhe rregullat e sjelljes të përcaktuara me Kodeksin etik të revizorëve të brendshëm si dhe orientimet ose udhëzimet nga ministri i Financave.

(4) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm dhe revizorët e brendshëm nuk duhet të kryejnë detyra të administrimit financiar dhe kontrollit dhe detyra të tjera në subjektin që nuk dalin nga funksioni i revizionit të brendshëm.

(5) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm dhe revizorët e brendshëm nuk mund të pezullohen ose të sistemohen në vend tjetër të punës për shkak të njoftimit për gjendjet e caktuara ose për dhënien e rekomandimeve të caktuara.

(6) Para se të ndërmerren masat disiplinore, sistemimi ose pezullimi i udhëheqësit të njësisë për revizion të brendshëm dhe revizorët e brendshëm, udhëheqësi i subjektit nga sektori publik obligohet që për atë ta njoftojë Njësinë Qendrore për Harmonizim dhe të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm.

(7) Sistemimi ose pezullimi i udhëheqësit të njësisë për revizion të brendshëm ose revizorët e brendshëm realizohen pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga ministri i Financave.

Neni 34

(1) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm është kompetent që në mënyrë të drejtpërdrejtë ta njoftojë udhëheqësin e subjektit nga sektori publik për të gjitha çështjet revizore të subjekti nga sektori publik, e veçanërisht për:

- rregullshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin e realizimit të buxhetit/planit financiar,
- rregullshmërinë dhe efikasitetin e kontrollit të brendshëm financiar, duke përfshirë administrimin me mjetet dhe
- harmonizimin e raporteve të kontabilitetit për realizimin e buxhetit/planit financiar me standardet e kontabilitetit.

(2) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm jep mendime për rregullat e brendshme dhe aktet e subjektit nga sektori publik në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm financiar dhe revizionin e brendshëm para se të hyjnë në fuqi këto rregulla dhe akte.

(3) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm i këshillon të gjithë personat udhëheqës në subjektin nga sektori publik për administrim me rrezikun.

6. Kushtet që duhet t'i plotësojë udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm, revizorët e autorizuar të brendshëm dhe revizorët e brendshëm

Neni 35

(1) Udhëheqës i njësisë për revizion të brendshëm mund të emërohet revizori i brendshëm i autorizuar i cili krahas kushteve nga neni 36, paragrafi (2), alinetë 1, 2 dhe 4 të këtij ligji, ka së paku tri vjet përvojë pune në sferën e revizionit të brendshëm ose të jashtëm.

(2) Udhëheqës i njësisë për revizion të brendshëm nuk mund të emërohet personi çifti bashkëshortor i të cilit, farefisi në vijë të drejtë pa kufizim, në vijën anësore deri në brezin e katërt ose në bazë të martesës deri në shkallën e katërt janë ose kanë qenë të punësuar në vendin udhëheqës të punës në subjektin nga sektori publik në dy vitet paraprake.

(3) Për rrethanat nga paragrafi (2), të këtij neni, udhëheqësi i subjektit duhet të njoftohet me shkrim nga kandidati për vendin e punës udhëheqës i njësisë për revizion të brendshëm gjatë kohës së emërimit.

Neni 36

(1) Revizorët e autorizuar të brendshëm dhe revizorët e brendshëm i emëron udhëheqësi i subjektit nga sektori publik.

(2) Revizorë të autorizuar të brendshëm mund të emërohen personat të cilët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj i plotësojnë edhe kushtet e veçanta vijuese:

- të kenë të kryer arsimimin e lartë,
- të kenë mbajtur trajnimin dhe të kenë dhënë provimin për revizorë të autorizuar të brendshëm në sektorin publik sipas Programin për dhënien e provimit për revizorë të autorizuar të brendshëm ose të posedojnë certifikatë revizore të njohur ndërkombëtarisht,
- të kenë së paku dy vjet përvojë pune në revizionin e brendshëm ose të jashtëm, dhe
- me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar masë ndalim për kryerjen e veprimtarisë ose profesionit derisa zgjat ndalesa;

(3) Revizorë të brendshëm mund të caktohen personat të cilët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj i plotësojnë edhe kushtet e veçanta vijuese:

- të kenë të kryer arsimimin e lartë,
- të kenë dy vjet përvojë pune në revizionin e brendshëm ose të jashtëm; dhe
- me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar masë ndalim për kryerjen e veprimtarisë ose profesionit derisa zgjat ndalesa.

(4) Revizorë të brendshëm në trajnim mund të jenë persona të punësuar të cilët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj i plotësojnë edhe kushtet e veçanta vijuese:

- të kenë të kryer arsimimin e lartë; dhe
- me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar masë ndalim për kryerjen e veprimtarisë ose profesionit derisa zgjat ndalesa.

(5) Pas skadimit të periudhës prej dy vjetësh, revizori në trajnim emërohet për revizor të brendshëm.

(6) Trajnimin nga paragrafi (2), alineja 2, të këtij neni e koordinon Njësia Qendrore për Harmonizim.

(7) Ministri i Financave e përcakton programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për revizor të autorizuar të brendshëm nga paragrafi (2) i këtij neni.

7. Të drejtat e revizorëve të brendshëm

Neni 37

Revizori i brendshëm i ka këto të drejta:

- të hyjë në lokalet e subjektit nga sektori publik ku bëhet revizioni, duke marrë parasysh rregullat për siguri dhe sjellje të mirë,
- të ketë qasje te dokumentet përkatëse lidhur me revizionin te subjekti nga sektori publik, si dhe dokumentet që përmbajnë të dhëna me shkallë përkatëse të sekretit dhe dokumentet tjera dhe të dhënat që ruhen në formë elektronike, duke iu përmbajtur dispozitave për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe të dhënave personale. Të kërkojë kopje të verifikuara, certifikata ose vërtetime nga këto dokumente dhe në raste të caktuara t'i marrë dokumentet origjinale, duke lënë kopje me vërtetim për pranimin,
- të kërkojë informacion gojor ose me shkrim nga cilido i punësuar ose udhëheqës i subjektit nga sektori publik në të cilin bëhet revizioni,
- të kërkojë informacione nga cilido bartës i informacioneve në subjektin nga sektori publik; dhe
- të kërkojë informacione nga institucionet tjera lidhur me punën dhe administrimin me subjektin nga sektori publik në të cilin bëhet revizioni.

8. Konflikti i interesave

Neni 38

Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm, përkatësisht revizori i brendshëm nuk duhet të marrë pjesë në revizion nëse ekziston ndonjëri nga llojet e konflikteve vijuese të interesave:

- gjatë vitit paraprak, udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm, përkatësisht revizori ka qenë i punësuar në njësinë organizative të subjektit nga sektori publik në të cilin bëhet revizioni,
- gjatë vitit paraprak udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm, përkatësisht revizori, bashkëshortori i tij ose farefisi deri në shkallën e dytë ka udhëhequr në subjektin nga sektori publik në të cilin bëhet revizioni,
- udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm, përkatësisht revizori, bashkëshortori i tij ose farefisi deri në shkallën e dytë kanë pjesë ose akciza në subjektet që shfrytëzojnë mjete që paraqesin të dala shtetërore, kurse të njëjtit kanë marrëdhënie afariste me subjektet nga sektori publik në të cilin bëhet revizioni; dhe
- ekzistojnë rrethana të tjera që mund të shpijnë te konflikti i interesave me vlerësimin e udhëheqësit të njësisë për revizion të brendshëm për të cilin ai jep arsyetim në formë të shkruar.

Neni 39

Udhëheqësi i subjektit nga sektori publik përkatësisht udhëheqësit dhe të punësuarit në subjektin nga sektori publik në të cilin bëhet revizioni i kanë detyrimet si vijon:

- të ndihmojnë dhe bashkëpunojnë gjatë kohës së revizionit,
- të sigurojnë informacione gojore ose me shkrim, deklarata me kërkesën e revizorit, qasje te dokumentet, bazat elektronike ose te cilido bartës i informacioneve,
- të dorëzojnë fotokopje të verifikuara nga dokumentet e kërkuara, si dhe t'i paraqesin dokumentet e kërkuara origjinale me vërtetim për pranimin e të njëjtave,
- me kërkesë të revizorit, të japin deklaratë për kompletimin e dokumenteve dhe të dhënave,
- në bazë të konstatimeve dhe rekomandimeve revizore, të përgatisin dhe t'i parashtrojnë udhëheqësit të njësisë për revizion të brendshëm plan aksionar për zbatimin e rekomandimeve, ku caktohen personat përgjegjës dhe afatet përfundimtare për ndërmarrjen e masave të domosdoshme në suaza të kompetencave të tyre,
- t'i zbatojnë rekomandimet dhe ta informojnë udhëheqësin e subjektit nga sektori publik dhe udhëheqësin e njësisë për revizion të brendshëm për zbatimin e planit aksionar; dhe
- të sigurojnë kushte përkatëse për punën e revizorëve.

9. Planifikimi i revizionit të brendshëm

Neni 40

(1) Revizioni i brendshëm bëhet në bazë të:

- planit strategjik për periudhën prej tre vjetësh,
- planit vjetor dhe
- planit për revizion të ndarë.

(2) Planin strategjik dhe vjetor për kryerjen e revizionit të brendshëm e miraton udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm pas marrjes së pëlqimit nga udhëheqësi i subjektit nga sektori publik në bazë të vlerësimit të kryer të rreziqeve.

(3) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm për çdo revizion ndaras miraton plan dhe program me të cilin më konkretisht përshkruhen procedurat revizore.

(4) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm më së voni deri më 15 dhjetor në vitin rrjedhës ia dorëzon planin strategjik për tre vitet e ardhshme dhe planin vjetor për revizion për vitin e ardhshëm Njësisë Qendrore për Harmonizim dhe udhëheqësve në njësitë organizative të subjekteve nga sektori publik të përfshira me planin vjetor.

10. Ndryshim i planit vjetor për revizion

Neni 41

(1) Plani vjetor për revizion mund të ndryshohet nëse vjen deri te ndryshimi i konsiderueshëm i rrezikut të vlerësuar ose resurseve të planifikuara gjatë përgatitjes së planit vjetor.

(2) Për ndryshimin e planit vjetor udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm e njofton Njësinë Qendrore për Harmonizim.

11. Realizimi i revizionit të brendshëm

Neni 42

(1) Revizioni bëhet me verifikimin, analizimin, vlerësimin dhe dokumentimin e të dhënave, të mjaftueshme për dhënien e mendimit profesional për qëllimet e parashtruara.

(2) Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm në pajtim me udhëheqësin e subjektit nga sektori publik mund të angazhojë edhe ekspertë që do të ndihmojnë gjatë realizimit të revizionit të brendshëm në lëmi të caktuara.

(3) Për çdo realizim të revizionit të brendshëm përgatitet raport revizor i cili përmban rezyme, qëllime dhe përfshirje të revizionit, konstatime, përfundime dhe rekomandime.

(4) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e realizimit të revizionit të brendshëm dhe mënyrën për njoftimin e revizionit të subjektit nga sektori publik.

12. Rregullat e veçanta revizore te subjekti nga sektori publik

Neni 43

(1) Njësia për revizion të brendshëm mund të përgatisë shtesë personale të Doracakut për revizion të brendshëm nga neni 27 të këtij ligji, nëse ka specifika gjatë punës.

(2) Shtesa e Doracakut nga paragrafi (1) të këtij neni i dorëzohet Njësisë Qendrore për Harmonizim.

IV. KOMITETI PËR MENAXHIM FINANCIAR DHE KONTROLL DHE REVIZION I BRENDESHËM

1. Komiteti për menaxhim financiar dhe kontroll

Neni 44

(1) Ministri i Financave formon Komitet për menaxhim financiar dhe kontroll si trup konsultativ për çështjet lidhur me administrimin dhe kontrollin financiar.

(2) Në Komitetin për menaxhim financiar dhe kontroll mund të jenë anëtarë udhëheqës të njësive për çështje financiare të ministrive. Me komitetin kryeson sekretari shtetëror i Ministrisë së Financave, kurse sekretari është udhëheqës i Njësisë Qendrore për Harmonizim.

(3) Komiteti për menaxhim financiar dhe kontroll takohet së paku një herë në tre muaj, kurse në rast urgjence kryetari mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme.

(4) Komiteti për menaxhim financiar dhe kontroll miraton rregullore për punë.

2. Komiteti revizor

Neni 45

(1) Ministri i Financave formon Komitet revizor, si trup konsultativ për çështjet lidhur me revizionin e brendshëm.

(2) Në Komitetin revizor mund të bëjnë pjesë udhëheqës të njësive për revizion të brendshëm, përkatësisht revizorë të brendshëm nga ministrinë. Me komitetin kryeson sekretari shtetëror i Ministrisë së Financave, kurse sekretari është udhëheqësi i Njësisë Qendrore për Harmonizim.

(3) Komiteti revizor takohet së paku një herë në tre muaj, kurse në raste urgjence kryetari mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme.

(4) Komiteti revizor miraton rregullore pune.

Neni 46

Në subjektet nga neni 4 të këtij ligji mund të formohen: komiteti për menaxhim financiar dhe kontroll dhe komitete revizore.

V. NJOFTIM PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLL DHE REVIZION TË BRENDSHËM

Neni 47

(1) Udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor nga vija e parë nga sfera e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (përveç Entit Shtetëror për Revizion), fondeve dhe komunave dhe Qytetit të Shkupit është i obliguar që Njësisë Qendrore për Harmonizim t'i dorëzojë Raport financiar vjetor më së voni deri më 10 maj në vitin rrjedhës për vitin paraparak.

(2) Raporti financiar vjetor veçanërisht përmban:

- raport për mjetet e planifikuara dhe të shpenzuara sipas zëreve (pasqyrë tabelore krahasuese),

- raport për programet projektet dhe marrëveshjet e realizuara,

- llogari vjetore ose llogari vjetore të konsoliduar,

- raport për vetëvlerësimet e zbatuara nga neni 18 paragrafi (3) dhe (8) të këtij ligji (rezultate nga vetëvlerësimet të cilat nuk janë plotësisht pozitive, komente të udhëheqësit të subjektit që kanë të bëjnë me rekomandimet nga vet-vlerësimet dhe mendim për administrim dhe kontrollin financiar),

- deklaratë për kualitetin dhe gjendjen e kontrolleve të brendshme,

- raport për aktivitetet për themelimin dhe zhvillimin e administrimit dhe kontrollit financiar dhe

- raport për revizionet e bëra dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm.

(3) Ministri i Financave së afërmi e përcakton formën dhe përmbajtjen e raporteve nga paragrafi 2, alineja 1, 2, 4, 6 dhe 7 dhe deklaratës nga paragrafi 2, alineja 5 të këtij neni.

VI. NJËSIA QENDRORE PËR HARMONIZIM

Neni 48

Njësia Qendrore për Harmonizim është kompetente për:

- përgatitjen e ligjeve dhe akteve nënligjore nga sfera e menaxhimit financiar dhe kontroll dhe revizionit të brendshëm,

- përgatitjen e metodologjisë dhe standardeve për punë për menaxhim financiar dhe kontroll dhe revizionin e brendshëm,

- koordinimin e trajnimeve për udhëheqësit të punësuarit e përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontroll dhe revizionin e brendshëm,

- koordinimin gjatë vendosjes dhe zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar,

- përgatitjen e lejes për risistemime ose lëshime të revizioneve të brendshëm nga neni 33 paragrafi (7) të këtij ligji,

- vendosjen dhe mbajtjen e bazës së të dhënave të njësisë për revizion të brendshëm dhe kartave të miratuara,

- vendosjen dhe mbajtjen e regjistrit të revizorëve të autorizuar të brendshëm që e kanë dhënë provimin për revizor të autorizuar të brendshëm në sektorin publik dhe posedojnë certifikatë për revizor të njohur ndërkombëtarisht,

- bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet nga kontrolli publik i brendshëm financiar nga vendi dhe jashtë dhe këmbim i informatave për zhvillim të kontrollit publik të brendshëm financiar,

- supervizionin e kualitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit,

- supervizionin e kualitetit të punës të njërive për revizion të brendshëm dhe
- përgatitjen e Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit publik të brendshëm financiar në bazë të raporteve financiare vjetore nga neni 47 të këtij ligji që Ministria e Financave ia dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, më së voni deri në fund të korrikut të vitit rrjedhës për vitin paraprak dhe
- organizimin e ad-hoc revizioneve që i kryejnë revizorët e brendshëm nga subjektet e ndara nga sektori publik, për revizionet të cilat lënda e revizionit e tejkalon përfshirjen përkatësisht kompetencën e subjektit të ndarë nga sektori publik ose lënda e revizionit është e asaj natyre që të hyrat multidisiplinore të revizionit të brendshëm janë më të dobishme. Konstatimet dhe rekomandimet e këtij lloji të revizionit do të diskutohen me subjektet e reviduara dhe raportin përfundimtar të dorëzuar te subjektet e involvuara.

Neni 49

(1) Udhëheqësi i subjektit është i obliguar që t'u sigurojë qasje të punësuarve nga Njësia Qendrore për Harmonizim të dokumentet, evidenca e kontabilitetit dhe informatat tjera të nevojshme për përcjelljen e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe revizionit të brendshëm.

(2) Qasja nga paragrafi (1) të këtij neni sigurohet pas marrjes së autorizimit me shkrim nga ministri i Financave.

VII. NDËRMARRJA E MASAVE KUNDËR PARREGULLSIVE DHE MASHTRIMEVE

Neni 50

(1) Udhëheqësi i subjektit nga sektori publik ka për obligim që ta pengojë rrezikun nga parregullsitë dhe mashtrimet dhe të ndërmarrë veprime kundër parregullsive dhe mashtrimeve.

(2) Udhëheqësi i subjektit nga sektori publik emëron person i cili do të njoftojë për parregullsitë dhe dyshimet për mashtrime ose korrupsion dhe në mënyrë të pavarur i ndërmerr masat të paragrafi (5) të këtij neni.

(3) Të gjithë të punësuarit duke përfshirë edhe revizorët e brendshëm e njoftojnë udhëheqësin e subjektit nga sektori publik dhe personin e obliguar për parregullsi, për parregullsitë ose dilemat për mashtrime ose korrupsion.

(4) Nëse revizori i brendshëm dyshon për mashtrim ose korrupsion gjatë kryerjes së revizionit, për atë e njofton udhëheqësin e njësisë për revizion të brendshëm i cili ka për obligim të paraqesë njoftim me shkrim udhëheqësit të subjektit nga sektori publik dhe personit të obliguar për parregullsi.

(5) Pas marrjes së njoftimit për ekzistimin e parregullsive ose dyshimin për mashtrime ose korrupsion, personi i obliguar për parregullsi i ndërmerr masat e nevojshme dhe për atë i njofton: Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë, Ministrinë e Financave-Drejtorinë për Polici Financiare dhe inspeksion financiar të sektorit publik, kurse në afat prej 15 ditësh për masat e ndërmarra në formë të shkruar e njofton personin i cili ka paralajmëruar për parregullsitë ose mashtrimet, përveç në rast të denoncimit anonim.

(6) Nëse personat nga paragrafi (3) të këtij neni nuk njoftohen për masat e ndërmarra përkatëse, ata për këtë i njoftojnë organet nga paragrafi (5) të këtij neni. Njësia Qendrore për Harmonizim nuk është trup kompetent për denoncimin e parregullsive dhe mashtrimeve.

(7) Të punësuarve, duke i përfshirë edhe revizorët e brendshëm të cilët kanë denoncuar parregullsi ose dyshim për mashtrim u sigurohet mbrojtja e identitetit dhe të drejtave të fituara nga marrëdhënia e punës në bazë të ligjit.

(8) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit të Financave e përcakton procedurën për parandalimin e parregullsive, mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellë, formën dhe përmbajtjen, afatet dhe mënyrën e njoftimit për parregullsitë.

VIII. MBIKËQYRJA INSPEKTUESE E FINANCAVE PUBLIKE

Neni 51

- (1) Ministria e Financave është kompetente për mbikëqyrjen inspektuese të financave publike.
- (2) Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes inspektuese të financave publike është ndërmarrja e aktiviteteve në lidhje me ankesat ose dyshimet e paraqitura për mashtrime ose korrupsion.
- (3) Mbikëqyrja inspektuese e financave publike kryhet në pajtim me principet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe besueshmërisë.
- (4) Punët e mbikëqyrjes inspektuese të financave publike në mënyrë të drejtpërdrejtë i kryejnë inspektorët e financave publike.

IX. KONTROLLIMI I SHFRYTËZIMIT TË MJETEVE NGA FONDET E UE

Neni 52

- (1) Subjektet të cilat shfrytëzojnë mjete nga Fondet e Unionit Evropian janë të detyruara që krahas dispozitave të këtij ligji, t'i kenë parasysh dhe t'i zbatojnë kushtet e veçanta për administrimin financiar, kontrollet e brendshme dhe revizionin e brendshëm, të caktuara nga Komisioni Evropian.
- (2) Të gjithë shfrytëzuesit e mjeteve të fondeve nga Unioni Evropian duhet t'u mundësojnë personave të autorizuar zyrtarë nga Ministria e Financave, inspektorëve të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Revizorëve qasje të lirë të tërë dokumentacioni, zyrat, mjetet dhe personeli duke pasur parasysh rregullat për siguri dhe sjellje të mirë.

X. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 53

Për kundërvajtjen e bërë udhëheqësit të subjektit do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 1 000 deri 2 000 euro me kundërvlerë në denar nëse:

- 1) nuk themelon sektor/seksion për çështje financiare (neni 9);
- 2) ndërmerr detyrim financiar për ndarjen e subvencionit, huas ose garancisë palës së tretë ose pjesëmarrje në kapitalin aksionar, që nuk është verifikuar me ligj (neni 22 paragrafi (1)) dhe
- 3) nuk i dorëzon Raport vjetor financiar Njesisë Qendrore për Harmonizim (neni 47).

Neni 54

Për kundërvajtjen e bërë udhëheqësit të subjektit nga sektori publik do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 1 000 deri 2 000 euro me kundërvlerë në denarë nëse:

- 1) nuk themelon njësi për revizion të brendshëm. (neni 30 dhe 31);
- 2) risistemon ose suspendon udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm ose revizor të brendshëm pa marrjen e lejes paraprake me shkrim nga ministri i Financave (neni 33 paragrafi (7));
- 3) personi përgjegjës ose i punësuar në subjektin nga sektori publik në të cilin bëhet revizioni i brendshëm nuk i përmbush detyrimet nga neni 39 të këtij ligji;
- 4) nuk u siguron qasje të punësuarve në Njësinë Qendrore për Harmonizim të dokumentet, evidenca e kontabilitetit dhe informacione tjera të nevojshme për ndjekjen e funksionimit të administrimit dhe kontrollit financiar dhe revizionit të brendshëm (neni 49);
- 5) nuk i ndërmerr veprimet e nevojshme kundër parregullsive dhe mashtrimeve (neni 50 paragrafi (1));
- 6) nuk emëron person përgjegjës për parregullsitë (neni 50 paragrafi (2));
- 7) revizorit të punësuar ose të brendshëm nuk i siguron mbrojtje të identitetit dhe të drejtave të fituara nga marrëdhënia e punës në rast të njoftimit për parregullsi, dyshimit për mashtrim ose korrupsion (neni 50 paragrafi (7)), dhe

8) nuk u mundëson personave zyrtarë të autorizuar nga Ministria e Financave, inspektorëve nga Komisioni Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Revizorëve qasje të lirë të tërë dokumentacioni, zyrat, mjetet dhe personeli (neni 52 paragrafi(2)).

Neni 55

(1) Për kundërvajtjet nga neni 53 dhe 54 të këtij ligji procedurë për kundërvajtje mban edhe sanksion për kundërvajtje prononcon gjykata kompetente.

(2) Kërkesën për ngritjen e procedurës për kundërvajtje të gjykata kompetente e dorëzon Ministria e Financave.

(3) Për dispozitat nga neni 53 dhe 54 të këtij ligji nuk do të mbahet procedurë për barazim dhe ndërmjetësim.

XI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 56

(1) Dispozitat nënligjore të këtij ligji do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të dispozitave nënligjore të paragrafit 1 të këtij ligji do të zbatohen dispozitat nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit për kontroll publik të brendshëm financiar (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 22/2007) dhe Ligjit për revizion të brendshëm në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 69/2004 dhe 22/2007).

Neni 57

(1) Udhëheqësi i subjektit do të emërojë udhëheqës të njësisë për çështje financiare nga neni 9 të këtij ligji, në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Udhëheqësi i njësisë për çështje financiare, në pajtim me udhëheqësin e subjektit, do të miratojë plan për vendosjen dhe zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit nga neni 12 paragrafi (1) të këtij ligji, në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Udhëheqësi i subjektit do të emërojë person të obliguar për parregullsitë në pajtim me nenin 50 të këtij ligji, në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 58

Subjektet nga sektori publik janë të obliguar që të vendosin revizion të brendshëm në pajtim me nenin 30, paragrafi (3), alineja 2 dhe 31 të këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 59

Dispozitat nga neni 30 paragrafi (3) alineja 2 dhe 36 paragrafi (2) do të zbatohen nga 1 janari 2011.

Neni 60

Dispozitat nga neni 51 i këtij ligji do të vlejné deri në rregullimin e punës së inspeksionit financiar në sektorin publik me ligj të posaçëm.

Neni 61

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për kontroll të brendshëm publik financiar (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 22/2007) dhe Ligji për revizion të brendshëm në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 69/2004 dhe 22/2007).

Neni 62

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.